

**STATUTI I SHOQERISE**  
**DHE**  
**AKTI I THEMELIMIT**  
**TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"MS Construction" SH. P. K**

Shtetasi Redi Struga , i lindur me 22.09.1982 , ne Tirane, me banim ne Rruga Bardhyl; nd.22; h. 1; ; njësia administrative nr. 3; njësia bashkiake nr. 3; 1005;Tirane, identifikuar me ane te Kartes se identitetit I20922121O, madhor me zotesi te plete per te vepruar, nen cilësinë e ortakut themelues.

Shtetasi Sokol Metoja, i lindur me 18.06.1982 , ne Tirane, me banim ne Rruga Blv. Zhanë d'Ark; nd. 107; h. 1; ; njësia administrative nr. 3; njësia bashkiake nr. 3; 1005; Tiranë, identifikuar me ane te Kartes se identitetit I20618075A madhor me zotesi te plete per te vepruar, nen cilësinë e ortakut themelues krijojnë:

Sotë me datën 21 Korrik 2021 Z.Redi Struga dhe Z.Sokol Metoja krijoj Shoqërinë me përgjegjësi te kufizuar "MS Construction" SH. P. K, me seli ne Rruga: "Qemal Stafa", pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, Njesia Bashkiake nr.8 perballe Qendres Lincoln.

Statuti është akti baze ku do te mbështetet themelimi i shoqërisë tregtare "MS Construction" SH. P. K, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i saj.

**KREU I**

**NENI 1**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**1.1** Ortakët e kesaj shoqerie Z. Redi Struga dhe Z. Sokol Metoja jane zoteruesit 100 % te kapitalit te shoqerise. Ne perqindje si me poshte:

1. Z. Redi Struga do te zoterojne 50% te aksjoneve.
2. Z. Sokol Metoja do te zoterojne 50% te aksjoneve

**NENI 2**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

**2.1**.Shoqeria mban emrin "MS Construction" SH. P. K dhe eshte person juridik shqiptar.



**2.2.Kjo shoqeri e fiton personalitetin e saj juridik me regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.**

**2.3.Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislatacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne aktin e themelimit dhe statutit, si dhe ne kontratat respektive.**

### **NENI 3**

#### **SELIA E SHOQERISE**

**3.1. Shoqeria "MS Construction" SH. P. K, e ka qendren e selise ne Rruga "Qemal Stafa", pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, perballë Qendres Lincoln. Njesia Bashkiake nr.8, Tirane**

### **NENI 4**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

**4.1. Objekti i Veprimtares Shoqërisë është :**

Ndertime te ndryshme kulturore,shteterore,shendetesore,bujqesore,fabrika,uzina, banesa etj.Projekttime,instalime,punime restaurimi etj.Veprimtari ne fushen e transportit,te mallrave brenda dhe jashte vendit,me mallrat te vete shoqerise dhe te te treteve.Import-eksport ne pergjithesi brenda dhe jashte vendit. Import-eksport mobilje, veshje MBF, mobilim sallash konferencash, parket, moket. Ndricim, import-eksport, ndricim tavanesh. Veprimtari ne fushen e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis dhe auditimin mjedisor, veprimtarite e lidhura me mbrojtjen kunder zjarrit dhe auditimit te energjise.Grubullim dhe transportim te mbetjeve inerte. Ndertim ujesjellesa, kuz, mbrojtje lumore, diga, etj.Aplikim dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i te gjitha Lejeve, Licencave, Autorizimeve dhe Miratimeve paraprake/perfundimtare, te cilat mundesojne ndertimin e objekteve te reja gjeneruese te energjise' elektrike te cilat shfrytezojnë burimet e rinovueshme te energjise si dielli, era, uji, etj, si dhe i veprave te tyre ndihmese, dhe zhvillimin e ketyre aktiviteteve ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise; Implementimi, menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjise elektrike, te cilat shfrytezojnë burimet e rinovueshme te energjise si dielli, era, uji, etj, si dhe i veprave te tyre ndihmese, si dhe shfrytezimi operimi dhe mirembajtja e tyre; Importi dhe eksporti i mallrave e paisjeve te teknologjive te ndryshme ne fushen e energjise elektrike, qe perdoren per ndertimin, mirembajtjen dhe menaxhimin e centraleve/sistemeve/impjanteve fotovoltaike, eolike, hidrike

(perfshire panelet diellore, turbinat e eres, inverterat, transformatoret, linjat e transmetimit/shperndarjes, dhe gjithe aksesoret/pajisjet e tjera te konvertimit, transmetimit, sinjalizimit, monitorimit, mbrojtjes, transmetimit te te dhenave), etj; Shitia e energjise elektrike me shumice dhe/ose pakice tek operatoret publik apo privat, pjesemarresit e tregut te energjise elektrike, perfshire ketu tregtaret, furnizuesit, konsumatoret e medhenj/te vegjel, vendas apo te huaj, nepermjet platformave shteterore apo private, kontratave bilaterale apo marreveshjeve, te njoitura, certikuara, licencuara, miratuara nga organeve kompetente/pergjegjese dhe entitetet perkatese ne fushen e Blerja e energjise' elektrike me shumice dhe/ose pakice nga operatoret publik apo privat, pjesemarresit e tregut te energjise elektrike, perfshire tregtaret, furnizuesit, vendas apo te huaj, nepermjet platformave shteterore apo private, kontratave bilaterale apo marreveshjeve, te njoitura,certikuara, licencuara, miratuara nga organet kompetente/pergjegjese dhe entitetet perkatese ne fushen e energjise elektrike; Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve per te cilat eshte kriuar, i cili nuk ndalohet me ligj.

**4.2.** Aktivitetet e sipërpërmendura do te realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe kon formë me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, te miratuar nga ortakët e saj.

**4.3.** Shoqëria mund te zgjeroje ose kufizoje fushën e veprimitarisë se saj ne çdo kohe.

#### **NENI 5**

#### **PERGJEGJESIA E ORTAKUT TE VETEM**

**5.1.** Pjesemarrja ne shoqeri nuk pengon pavaresine ligjore, organizative dhe te pronesise se ortakut te vetem.

**5.2.** Ortaket qe merr pjese ne kete shoqeri, nuk eshte pergjegjes per detyrimet qe lindin gjate aktivitetit tregtar te shoqerise, tej kapitalit themeltar te saj, qe vete ai ka nenshkruar, gjithashtu shoqeria nuk perjigjet per detyrimet personale te ortakut te saj.

#### **NENI 6**

#### **KOHEZGJATJA**

**6.1.** Shoqeria do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj.

NENI 7

### SIMBOLET E SHOQUERISE

7.1. Shoqeria do te kete vulen e saj "MS Construction" SH. P. K

KREU II

NENI 8

### KAPITALI I SHOQUERISE

8. Kapitali i shoqerise "MS Construction" SH. P. K eshte 100.000 leke e cili perbehet nga:

8.1. Kapitali ne para me vlore te barabarte me 100.000 (nje qindmije) leke

8.2. Shoqeria "MS Construction" SH. P. K perbehen nga 2(dy) kuota, me vlore nominale 1 (nje) kuote eshte barbarte me 50.000 (pesedhjetemije) leke.

8.3. Ortaket përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt te treteve deri ne vlerën e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqërisë.

NENI 9

### TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

9.1. Kapitali themeltar ose pjese te vecanta te tij, jane te transferueshme nga ortaku tek te tretet. Transferimi i kapitalit apo pjeseve te tij nga Ortaku ne favor te treteve, kryhet gjithnjë me akt notarial te posacem.

9.2. Shoqeria mund te rri si kapitalin themeltar ose mund ta zvogeloje ate, por gjithrrejo nen kufirin e 100.000 (nje qindmije) leke. Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit behet me vendim te ortakve te shoqerise dhe sipas parashikimeve te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

9.3. Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne shërbime, nëpërmjet emërimit te një eksperti te autorizuar për këto kontribute ne natyre sipas kërkjesës së administratorit.

9.4. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortaket e shoqërisë në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

9.5. Vendmi per zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

**NENI 10**  
**TRANSFERIMI I KUOTAVE**

**10.1.** Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

**10.2.** Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

**10.3.** Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendrën Kombëtare te Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit t". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

**KREU III**

**NENI 11**

**ORGANI VENDIMMARRES**

**11.1.** Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKB për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

**11.2.** Ortaket , vendin për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve;
- g) ndryshimin e statutit, e selisë se shoqërisë, hapjen dhe mbylljen e filialeve te saj.
- h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit te shoqërisë;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.

**11.3.** Të gjitha vendimet e marra nga Ortaket e shoqërisë duhet te registrohen në



regjistrin e vendimeve, te dhënat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

**11.4. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.**

**11.5. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtoje pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.**

## NENI 12

### ADMINISTRATORI

**12.1. Administratori i shoqërisë mund te caktohet edhe një person tjeter, jashtë orokëve.**

**12.2. Administrator i shoqërisë vendose Znj.Jona Dervishi me nr te Kartes se identitetit J35807057L madhor me zotesi te plete per te vepruar.**

**12.3. Administratori i shoqërisë do te ushtroje kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me te drejte ripërtëritje bazuar ne nenin 95/1 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare".**

## NENI 13

### KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

**13.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:**

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe te jashtëzakonshëm te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ai vete.
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

c) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Ortakut te Vetëm shoqërisë ne mbledhjen e asamblesë se ortakeve.

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

**12.1** Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet.

**12.2.** Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve.

**12.3.** Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

#### **NENI 14**

#### **VITI FINANCIAR**

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

#### **NENI 15**

#### **BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET**

**15.1.** Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme, e përberë nga Ortaket miratojnë bilancin e paraqitur nga Administratori.

**15.2.** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga Ortaket vendosin rreth shpërndarjes se disidentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te mëparshëm finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

## NENI 16

### MBARIMI I SHOQERISE

**16.1.** Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Ortakeve ;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) Me vendim të gjykatës;

**16.2.** Ne ketë rast, Ortalet i Vetëm merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri ne likuidim e sipër ".

**16.3.** Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagues, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

**16.4.** Nëse Ortalet e shoqërisë nuk merrini një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

## NENI 17

### TRANSFORMIMI I SHOQERISE

**17.1.** Transformimi i shoqërisë behet me vendim te Ortakeve ose kur ekzistojnë faktorë te jashtëm detyrues ligjore, ne këto raste vendimi merret pasi i është paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqërisë nga ana e administratorit.

**17.2.** Çdo transformim i bere ne kundërshtim me ketë nen është i pavlefshëm.

## NENI 18

### BAZA LIGJORE

**18.1.** Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne përputhje te plete me ketë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

**18.2.** Për sa nuk parashikohet ne ketë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe akteve te tjera ligjore dhe nënligjore te dale ne zbatim te tyre ne Republikën e Shqipërisë.

**NENI 19**

**MOSMARREVESHJET**

**16.1.** Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te treteve, do te tentohet te zgjidhen me konsensus dhe mirëkuptim.

**16.2.** Ne rast te kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do te jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tirane.

**NENI 20**

**DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

**20.1.** Ky statut është hartuar me vullnetin e lire dhe te plete te Ortaket e shoqërisë dhe është nënshkruar prej tyre.

**20.2.** Ky Statut u redaktua ne katër kopje, tre ne gjuhen shqipe. Një kopje mbahet ne dokumentacionin baze te shoqërisë.

**Ortaket Themelues "MS Construction" SH. P. K**

Tirane me 21.09./2021

**ORTAKET**

Redi Struga  


Sokol Metoja  


**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI**

DATE 21/07/2021  
NR REP 5721

# VERTE TIM NENSUKRIMI

Sot me date 21.07.2021(dymije e njezete e nje) vertetoj nenshkrimin ortakeve te shoqerise "MS Construction" shpk, Z.Redi Struga, atësia Bujar, amësia Mirlinda, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Bardhyl; Nd. 22; H. 1; Njësia Administrative Nr. 3; Njësia Bashkiake Nr. 3; 1005; Tiranë, lindur më 22/09/1982, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037272870 dhe nr. personal I20922121O dhe Sokol Metoja, atësia Mustafa, amësia Bukurije, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Zhanë D'ark; Nd. 107, H. 1; Njësia Administrative Nr. 3; Njësia Bashkiake Nr. 3; 1005; Tiranë, lindur më 18/06/1982, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032706806 dhe nr. personal I20618075A, te cilet me deklaruan se Statuti dhe Akti i Themelimit i shoqerise eshte nenshkruar prej tyre eshte nenshkruar jashtë zyre notieriale dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit "Per Noterine".

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pikë 1, gërmë “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

## **NOTERE**

MAJLISINA DEMOLLARI

*NOTERE*  
Maglinda E. Demollier  
NPI#: K41606040A  
71-07006166